




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-21864/25 datë:21.08.2025



Npi – 01/286 datë: 22.08.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 22.08.2025, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -VIII- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 22.08.2025 (e premte) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Artan Lubovci, z.Arton Demiri, znj.Arjeta Maliqi dhe znj.Sabrie Veliu. Përveç anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Zyrtari për Komunitete dhe Kthim z.Muhamet Mehmeti, z.Besnik Ahmeti, DBF, znj.Vlora Hyseni, zyrtare për informim; Praktikantët znj.Hava Llugaxhiu, znj.Agnesa Ademaj, dhe znj.Admire Selmani. Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje, mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-së më 09.07.2025,
2. Diskutim mbi nevojat dhe mundësitë për ndërtim, rindërtim ose renovim të shtëpive për pjestarët në nevojë të komuniteteve Ashkali dhe Rom në komunën e Shtimes,
3. Raporti gjashtëmujor Buxhetor Janar - Qershor 2025,
4. Raporti i Auditimit për Pasqyrën Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024 nga ZKA,
5. Plani i Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrës Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes,
6. Draft - Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj - Gjilan.
7. Informatë mujore nga ZKKK-ja.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Sa i përket rendit të ditës unë pajtohem me këto pika përveq pikës 6 pasi që Drejtori i Shërbimeve Publike nuk ka me marrë pjesë. Prandaj nuk besoj që do të na hyjë në punë si Komitet përveq pikave tjera.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Arsyeja pse e kam vendos pikën 6 është se duke pas parasysh faktin që ky Komiteti është obligativ është dashur që të i bëhet si rekomandim Kuvendit për miratimin e këtij plani.

***Komiteti për Komunitete, me 6 vota “Për”, me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi rendin e ditës pa pikën 6, “Draft - Plani për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për rajonin Ferizaj – Gjilan”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-së më 09.07.2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 09.07.2025.**

Pika 2

Diskutim mbi nevojat dhe mundësitë për ndërtim, rindërtim ose renovim të shtëpive për pjestarët në nevojë të komuniteteve Ashkali dhe Rom në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Komuna e Shtimes së bashku me Ministrin e Planifikimit Hapësinor nëse nuk gaboj e kanë pas një thirrje të hapur për renovimin dhe ndërtimin e shtëpive. Po ashtu Komuna e Shtimes e ka një marrëveshje me OJQ “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin dhe renovimin e shtëpive ku edhe është bërë ndërtimi i disa shtëpive.

z.Besnik Seferi: Ndër pikat më të rëndësishme të këtij rendi të ditës është po kjo pikë, duke marrë parasysh që Komuniteti Rom dhe Ashkali kanë nevoja të shumta për renovim dhe ndërtim të shtëpive. Unë personalisht e di edhe me emra se cilat janë ato familje. Mirëpo unë kisha dashtë me e pyet z.Muhamet Mehmetin se sa kërkesa kanë qenë deri tash në ZKKK-ë?

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Përshëndetje. Atëherë, nga familjet e Komunitetit Rom dhe Ashkali kanë aplikuar gjithsej 5 familje, ku unë personalisht ju kam ndihmuar. Problemi kryesor gjatë aplikimit kanë qenë 3 kritere që është dashtë me u plotësu për me qenë përfitues. Është fjala për 3 dokumente: certifikata e pronës, fleta poseduese, ku disa familje që kanë apliku nuk kanë pas fletë poseduese me emrat e vet por në emër të dikujt tjetër, dhe lejen e ndërtimit po ashtu. Këto dokumente kanë qenë si ngecje problematike te këto familje, kam qenë në kontakt me drejtoreshën e Shëndetësisë dhe ka thënë që të aplikojn këto familje dhe pastaj ne e shohim se çfarë mund të bëjmë sa u përket këtyre dokumenteve.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Aktualisht Komuniteti Rom dhe Ashkali qëndron më mirë se në shumë Komuna të tjera. Një ndër rastet që vlen të përmendet është familja në Gjurovc e z.Ramadan Bajramit që ju është djegë shtëpija mirëpo nuk ka qenë përfitues për ndërtimin e shtëpisë, Komuna duhet që të shqyrtojë këtë rast. Po ashtu edhe familjet e Komunitetit Ashkali duhet të kenë mbështetje, po ashtu këto familje duhet të vizitohen dhe të shikohen mundësitë për mbështetje. Një ndër familjet që ka pas nevojë për renovim të shtëpisë ka qenë edhe familja ime mirëpo tani e kemi rregulluar dhe emri i familjes time është larguar nga lista.

z.Arton Demiri: Unë kisha thënë që këto familje sa ju përket thirrjeve të tilla për renovim dhe ndërtim të shtëpive duhet më herët të marrin informacione. Nuk duhet të lihen këto familje që për shkak të këtyre dokumenteve mos me qenë përfitues. Mendoj që problemi është edhe te ne që nuk ju kemi ndihmuar sa duhet. Deshta me pyet se a kanë bërë kërkesë te ZKKK-ja këto familje?

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Është problem me ju ndihmu sepse ka disa familje që tokat nuk i kanë në emrin e tyre dhe nuk mund të ju ndihmojm për këtë pjesë.

z.Besnik Seferi: Realisht ne mundemi me ju rekomandu mirëpo Komisioni është ai që vendos por ne duhet me ju dhënë një shtytje. Ne duhet të i bëjmë hapat konkret, nëse toka nuk është në emër të tij atëherë mundet me qenë një kontratë noteriale që e tregon këtë pjesë që toka është në emër të personit të caktuar. Përveq tjerash Kryesues ne e dimë që kemi një bindje të fortë që mos me ra në

gjunjë, mirëpo unë mendoj që edhe familja juaj duhet të jetë përfitues. Ne duhet me bërë lehtësira e aq më pak kur është ndarë një buxhet për renovimin dhe ndërtimin e shtëpive. Unë personalisht njoh familje dhe ju kam thënë të adresohen tek ZKKK-ja.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Një sçarim deshta ta bëjë, se familja ime më herët ka pas nevojë për renovim të shtëpisë mirpo tani jo sepse e kemi rregulluar. Duhet të falenderoj Kryetarin për ndërtimin e shtëpive të dy familjeve të Komunitetit Ashkali. Komisioni duhet të vijë dhe të vizitojë familjet e Komunitetit Rom e Ashkali që kanë nevojë. Ne duhet të i bëjmë rekomandim zyrës së Kryetarit që të i bëjë presion Komisionit që me i vizitu këto familje.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoj Kryetarin të Komunës së Shtimes, si dhe Drejtorive përkatëse që të rishikojnë të gjitha mundësitë financiare dhe të mbështesin familjet në nevojë të Komunitetit Rom dhe Ashkali në Komunën e Shtimes, në ndërtimin, ose renovimin e objekteve të banimit.**

Pika 3

Raporti gjashtëmuor Buxhetor Janar - Qershor 2025

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe në bazë të Ligjit për Menaxhimin Financave Publike dhe Përgjegjësitë, është bërë ky raport gjashtëmuor Buxhetor. Në vazhdim lexoi materialin (shih dokumentin). Të hyrat vetanake janë gjithsej 406,857.57 euro. Nëse ka pyetje dikush jam këtu për të u përgjigjur.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Faleminderit për raportin Drejtor, unë deshta që të pyes se për këtë raport a është diskutuar në muajin korrik?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Jo për këtë raport nuk kemi diskutuar sepse ky raport është dorëzuar me 21 korrik.

z.Besnik Seferi: Faleminderit, Drejtor për sçarimet dhe këtë raport gjashtëmuor Buxhetor. Një pjesë e madhe e shpenzimeve janë të planifikuara për muajin korrik. Ju përgëzoj për raportin dhe punën. Po ju kursej që ta diskutojmë në Kuvend.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Vetëm një sçarim raporti thotë që është shpenzuar 47.04% ka qenë shumë afër 50% mirëpo Ministria e Financave në fund të muajit Qershor në bazë të vendimit të Qeverisë e ka alokuar një shumë prej 262 mijë euro, po mos të ishte kjo shumë buxheti do të ishte diku 49.6% i shpenzuar, automatikisht në bazë të kësaj është ulë shpenzimi i buxhetit. Po besoj që deri në fund të vitit shpenzimi i buxhetit do të shkojë mbi 98%.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që t'i rekomandon Kuvendit të Komunës së Shtimes që të miratoi Raportin gjashtëmuor Buxhetor Janar – Qershor 2025.**

Pika 4

Raporti i Auditimit për Pasqyrën Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024 nga ZKA

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Po e them sinjerisht ky raport është një prej raporteve më të mira të të gjitha Komunave. Në këtë raport gjithsej kanë qenë 9 rekomandime. Prej tyre 5 rekomandime kanë qenë të reja ndërsa 4 të përsëritura ku po i përmendi secilen veq e veq. Në vazhdim lexoi materialin (shih dokumentin). Te Plani i Veprimit e kemi paraparë që brenda 3-4 muorit të parë me u pëmbush këto rekomandime.

z.Besnik Seferi: Faleminderit Drejtor për sqarimet, me sa e pashë patë të përsëritura. Si p.sh te rekomandimet për subvencione. Cili është ndikimi dhe përsëritja e këtyre të gjeturave?

z.Besnik Ahmeti, DBF: Te rekomandimet për subvencionet është e dhimshme me ndodhë ai rekomandim, është bërë shkelje sepse nuk është përmbush rregullorja. Është gjynah me u bërë ky

rekomandim pasi që zyrtarja në fjalë ka qenë Drejtoreshë më herët po në atë drejtori dhe ka pas përvojë në këtë pjesë, dhe nuk është dashur fare me i ik ai fakt.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi Raportin e Auditimit për Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Shtimes për vitin 2024, nga Zyra Kombëtare e Auditimit.**

Pika 5

Plani i Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrës Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Edhe këtu fatkeqësisht janë 9 rekomandime ku parashihet që brenda 3-4 mujorit të parë me u përmbyll, përveq rekomandimin që është bërë për vitin 2016-2020, është vështirë me përmbyll atë rekomandim brenda vitit.

z.Arton Demiri: Unë realisht vetëm deshta me e falenderu Drejtorin për raportin.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit të Komunës së Shtimes, që ta miratoi, Planin e Veprimit nga Raporti Vjetor i Auditimit të Pasqyrave Vjetore Financiare 2024 për Komunën e Shtimes.**

Pika 6

Informatë mujore nga ZKKK-ja

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Fjalën ja dha z.Muhamet Mehmetit.

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Përshëndetje. Ju kërkojë falje për mos dërgimin e materialit te ju. Te muaji Korrik-Gusht nuk kemi raste të adresuara. Pjesa tjetër është kjo thirrja që është bërë për renovim dhe ndërtim të shtëpive, ne si zyre ju kemi ndihmuar për aplikim mirëpo ka pas problem siç i përmenda edhe më herët dokumentet të cilat kanë paraqitë problem. Kemi dalë në teren sa ju përket aktiviteteve. Në vazhdim lexoi materialin (shih dokumentin). Kemi projekte prej IOM-it ku pritet që të ketë ndriçim dhe parqe nëpër fshatra. Siç e dimë buxheti është prej 10 mijë eurove që ju ka nda zyrës së ZKKK-së. Kërkesa kemi të shumta, nga fshatrat ku po ballafaqohemi me qera dhe probleme të mëdha shëndetësore etj. Këto ishin ato që i kemi bërë gjatë muajit Korrik-Gusht.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Mendoj që mundet me u përmirsu komunikimi në mes ZKKK-së dhe qytetarëve. Kisha rekomandu që në të ardhmen këto thirrje me u shpërnda nëpër fshatra. Po ashtu të hapet ndonjë grup në rrjete sociale që të informohen qytetarët e Komuniteteve Ashkali dhe Rom për të gjitha thirrjet që bëhen, pasi që ndoshta nuk po informohen me kohë. Njësia për Komunitete dhe Kthim ka hapur një mbështetje prej 8 mijë euro për bizneset. Të përgëzoj për punën dhe angazhimin tënd Muhamet.

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Për fat të keq siç e thashë edhe më herët kur është hapur thirrja unë kam qenë në pushim dhe më është dashtë 2-3 ditë më herët me ardhë për me ju ndihmu për aplikim qytetarëve. Normalisht që i pres rekomandimet e juaja dhe jemi aty për të ju ndihmuar të gjithëve.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Edhe një rekomandim deshta me e bërë te çështja e Planit të Veprimit është e nevojshme të diskutohet me grupin punues dhe të shihni se ku kanë mbetë.

z.Besnik Seferi: E falenderoj zyrtarin për informatat. Duhet të bëhet trysni te Ekzekutivi për çështje që kanë të bëjnë me Komunitetin Rom dhe Ashkali. E ke një Komitet për Komunitet mbrapa që të përkrahë për punën tënde. Në kuadër të kësaj zyre ka shumë kërkesa siç edhe i përmenda. Komuna ka mundësi por duhet me u bërë shtytje proceseve që të ecin përpara. Ka shumë gjëra që duhen të thuhën rreth Komitetit për Komunitete ku edhe ky Komitet spo gjen mbështetje. E ke ditur që ke përgjegjësi pasi e ke marrë këtë pozitë sepse është Komiteti i dytë më i madhë me rradhë në Shtime. Deshta me e cekë edhe rastin e një fëmije që është i sëmurë dhe ka nevojë për ndihmë dhe mbështetje, çfarë ka ndodhur me atë fëmijë?

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Jemi ballafaquar me shumë pjesë sfiduese kur e kam marrë detyrën. Sa i përket atij fëmijës unë i kam kërkuar prindit të tij që me e sjellë raportin për ta bërë pagesën prej 1 viti për barna, por prindi i tij ka thënë që pagesat më herët ju kanë bërë në dorë dhe nuk është paraqitur në zyrë më. Në gradualisht po punojm në vizita.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Duhet të kemi kujdes sa u përket këtyre gjërave, sepse njohë ZKKK-ë të Komunave të tjera që e kanë keqpërdor buxhetin e kësaj zyre. Unë të përgëzoj ty Muhamet për punën që po e bënë. Meqë diskutime tjera nuk ka kalojm te pika e fundit.

Pika 7

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi: Është hapë aplikimi për libra dhe sa po ju ndihmon ZKKK-ja për pjesën e aplikimit në E-Kosova?

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Para se të punoj në zyre unë kam punuar më herët në shkollë, ku kam bashkëpunuar me prind dhe ju kamë ndihmuar me apliku. Kam bërë kërkesë te UNMIK-u dhe KFOR-i për qanta dhe mjete shkollore.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: A kemi nxënës që nuk ka arrit me u regjistru në shkollë të mesme?

z.Muhamet Mehmeti, ZKKK: Vetëm një rast në Vojnovc e kemi, ku ka aplikuar në Ferizaj. Kam bërë intervenim te personat adekuat për këtë pjesë. Mbetet të shihet lista në fund se a ka nxënës të tjerë.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Unë jam interesuar për këtë rast dhe kam komunikuar me Drejtorin e Shkollës së Mesme në Ferizaj ku jemi dakorduar që njëherë me u pranë në një drejtim tjetër pastaj me u transferu.

znj.Arjeta Maliqi: Ka raste kur nuk mundesh me apliku në emër të babait pasi që E-Kosova nuk e lejon, të paktën këtë problem e kam pasur në herën e kaluar gjatë aplikimit ku është dashur që vetëm në emër të nënës ta bëjë aplikimin, si mund të i ndihmoni në këto raste nëse shfaqen përsëri?

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi: Aplikimi mund të bëhet në emër të cilit do prind, mirëpo nëse ke probleme të tilla më lajmëro.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Pasi që diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka, unë ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin e juaj dhe mbledhjen e përfundoj në ora 15:37h.

Procesmbajtës
Sadbere Halili





Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

